



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V\_343\_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_474\_10\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_474\_10\_10**;
6. Apelimi i KEK-ut me datë 23.02.2011;

**Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:**

#### VENDIM

**REFUZOHET** apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Bedri Sopi (shifra e konsumatorit DPR – 31921) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

#### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 30.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.03.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 07.08.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se duhet të bëhet ndërrimi i njehsorisë elektrik me nr. 6051007, pasi që njehsori elektrik ka qelqin e thyer dhe se i njëjti duhet dërgohet në qendrën e kalibrimit.

**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 01109, datë 07.08.2007

- Me datë 12.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorisë elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorisë elektrik nr. 6051007 dhe kanë vendosur për matje njehsorisë elektrik nr. 40861764 dhe vulosur me vulë distributive A2 0003978.

**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorisë elektrik nr. 001455 datë 12.01.2008

- Me datë 11.02.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorisë elektrik nr. 6051007, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqi i njehsorisë është i thyer, për rreth qelqit nga të dyja anët është futur shiriti filmik është penguar puna e diskut si dhe në brendi të njehsorisë ka pluhur të shiritit filmik.

**Provë:** Procesverbali me nr. 2/11 i datës 11.02.2008



- Me datë 21.05.2008 punëtorë e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbal i KEK-ut nr. 0141205 i datës 21.05.2008
- Me datë 01.07.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06092 në vlerë prej 2,577.84 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP06092 e datë 01.07.2008
- Me datë 09.07.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.03.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.03.2010
- Me datë 30.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 13.10.2010, DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_474\_10\_10, dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka vendosur të **aprovoje** ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfundim se:
  1. KEK-u duhet të shkarkoj konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06092 të datës 01.07.2008 në vlerë prej 2,577.84€.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_474\_10\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK-së. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së **ZRRE/DMK\_V\_474\_10\_10** të mbetet në fuqi.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar